



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

PLANI PËR INTEGRITET

(2024 – 2026)

22/01/2024

22/01/2024

PËRMBAJTJE

Deklarata e Integritetit.....	3
Hyrja	4
PËRMBAJTJA E PLANIT TË INTEGRITETIT	5
Qëllimet e Planit të Integritetit	6
Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit.....	6
Metoda e vlerësimit të rrezikut.....	7
Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi.....	8
Fushat e rrezikut.....	8

Deklarata e Integritetit

Plani i Integritetit është një dokument strategjik që synon të vendosë veprime për sigurimin e integritetit në realizimin e objektivave të universitetit tonë. Këto objektiva orientohen në ofrimin e shërbimeve efikase me përgjegjësi të lartë morale, të bazuar në transparencë dhe llogaridhënie gjatë proceseve vendimmarrëse të universitetit.

Plani i Integritetit thekson përkushtimin tonë për të fuqizuar kontrollet operative ekzistuese, ngritjen e standardeve profesionale dhe zbatimin e rregullave normative për parandalimin dhe shmangien e veprimeve që mund të kërcënojnë integritetin në arritjen e objektivave tona. Ky përkushtim shihet si parakusht për zhvillimin e një mjedisi akademik me transparencë dhe llogaridhënie të lartë.

Ne si institucion publik, zotohemi të mbajmë integritetin në të gjitha veprimtaritë tona. Do të respektojmë ndershmërinë, drejtësinë dhe vlerat etike në marrëdhëniet tona më të tjerët.

Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, si qendër e dijes dhe arsimit, deklaron zotimin e tij për integritet akademik dhe moral. Ne angazhohemi për të promovuar drejtësinë, ndershmërinë dhe kulturën e respektit në të gjitha aspektet e jetës universitare. Kemi synimin për të zhvilluar një mjedis të sigurt dhe inkurajues për hulumtimin e dijes dhe formimin e vlerave të qëndrueshme për studentët, stafin dhe komunitetin tonë.

Menaxhmenti i UKZ-së, ka përgjegjësinë kryesore të hartojë politika dhe rregullore me të cilat mbrohet integriteti persona, kolektiv, konform legjislacionit në fuqi dhe të bëjë monitorimin e zbatimit të tyre dhe jemi të vetëdijshëm se duhet të jemi ne të parët që japim shembullin për t'i shërbyer interesit publik, në mënyrë që të gjitha veprimet tona të jenë me integritet të lartë, me vlera etike dhe të bazuara në ligj.

Ndaj, kemi kënaqësinë të shprehim konsideratën tonë të lartë për ekipin e punës së UKZ-së, për angazhimin serioz për hartimin e këtij dokumenti. Njëkohësisht, ndihemi krenar të prezantojmë dokumentin e Planit të Integritetit për Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, si shprehje konkrete e vullnetit dhe përkushtimit për integritet institucional. UKZ ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në përmirësimin e kornizës rregullatore dhe operacionale të integritetit. Hapi i miratimit të këtij Plani Integriteti, është pikërisht një përpjekje për të hedhur themelet e një sistemi më të gjerë, i cili menaxhon risqet që kërcënojnë integritetin institucional.

Plani i Integritetit për institucionin tonë do të ndikojë pozitivisht në të gjitha veprimtaritë e UKZ. Jemi të ndërgjegjshëm se dhënia e shembullit personal dhe menaxhimi i integritetit që nga nivelet më të larta drejtuese, duke ndjekur para së gjithash standarde të larta profesionale dhe etikën, do të sigurojnë një zbatim efektiv të tij nga të gjitha nivelet: menaxhmenti (rektorat), njësitë akademike, administratës, studentëve dhe palëve të jashtme duke rritur në këtë mënyrë edhe besimin e publikut tek ne.

Titullari i Institucionit
Prof. Asoc. Dr Artan Dërmaku, Rektor



3

Hyrja

Universiteti ynë është një institucion i pavarur akademik, përgjegjës për kryerjen e detyrave të tij në pajtim me legjislacionin dhe rregulloret aktuale. Universiteti është i përkushtuar për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të studentëve, stafit dhe të gjithë pjesëmarrësve në jetën universitare.

Në pajtim me nenin 25 Ligjit nr.08/l-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe në përputhje me “Metodologjinë e Planeve të Integritetit” të cilat obligojnë të gjitha institucionet të hartojnë dhe miratojnë planet e integritetit.

Në përputhje me këtë angazhim, universiteti ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për një periudhë të caktuar, në këtë rast, tri vjetët 2024-2027. Ky plan përfshin masat dhe strategjitë që do të ndiqen për të siguruar integritetin në të gjitha sferat e aktivitetit universitar. Planin e Integritetit do të përditësohet dhe ndryshohet sipas identifikimit të nevojave dhe zhvillimeve të reja që mund të ndodhin gjatë kohës.

Plani i integritetit është një dokument brendshëm tre (3) vjeçar dhe përditësohet çdo vit. Është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cënueshmërisë së integritetit brenda Institucionit dhe që ofron masa për menaxhimin e integritetit për të arritur objektivat e integritetit të Institucionit.

Universiteti përgjigjet para Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe respekton të gjitha detyrimet dhe detyrat e tij, siç janë përcaktuara në legjislacionin që rregullon funksionimin e institucionit. Kjo përgjegjësi është theksuar edhe në Planin e Integritetit, duke përfshirë masat dhe procedurat për të adresuar çdo çështje që mund të ketë ndikim në integritetin dhe reputacionin e universitetit.

Përtej kësaj, universiteti është i hapur për përmirësime dhe kritika konstruktive. Përmes këtij plani, synojmë të kultivojmë një mjedis akademik të paanshëm, të ndershëm dhe të përgjegjshëm, duke përfshirë të gjithë pjesëmarrësit në këtë rrugë drejt një institucioni të fortë dhe të besueshëm në fushën e arsimit të lartë.

Plani rritet përkushtimin e UKZ-së për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet brenda fushëveprimit të institucionit.

Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të institucionit dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

PËRMBAJTJA E PLANIT TË INTEGRITETIT

Plani i Integritetit në Universitetin Publik “Kadri Zeka” përmban elementet e mëposhtëm:

- një vetëvlerësim të ekspozimit të institucionit ndaj korrupsionit dhe formave të tjera të shkeljes së integritetit;
- informacion për fushëveprimin e institucionit dhe burimet njerëzore të angazhuara në institucion;
- llojet e rreziqeve të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit;
- masat ekzistuese të kontrollit;
- masat parandaluese për zvogëlimin e rrezikut të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit dhe afatet për zbatimin e tyre;
- informacion për personin përgjegjës për menaxhimin e hartimit dhe zbatimin të planit të integritetit;
- të dhëna të tjera, në përputhje me Metodologjinë për hartimin e planit të integritetit.

Përmes Planit të Integritetit synohet:

- Rritja e mundësive që UKZ të arrijë objektivat e menaxhimit të integritetit;
- Identifikimi i rreziqeve dhe masave për zvogëlimin e rreziqeve;
- Përmirësimin e kontrolleve ndaj rreziqeve të identifikuara;
- Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale;
- Rritjen e besimit të stafit dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstron nga UKZ.

Qëllimet e Planit të Integritetit

- Sistem efektiv i menaxhimit të integritetit në institucion;
- Llogaridhënie publike dhe transparencë;
- Rezistencë institucionale ndaj cenimeve të integritetit;
- Planifikim i menaxhimit të rrezikut ndaj integritetit në institucion.

Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Universiteti ynë, duke u bazuar në detyrimet përkatëse ligjore nga Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe Metodologjinë për Planet e Integritetit, ka ndërmarrë veprime konkrete në inicimin e përgatitjes së Planit të Integritetit.

Zhvillimi i Planit të Integritetit përbëhet prej disa faza si në vijim:

- Faza e parë: Sekretari i Përgjithshëm i UKZ-së ka marrë vendim për caktimin e zyrtarit përgjegjës për menaxhimin e përgatitjes dhe zbatimit të Planit të Integritetit në UKZ (Vendimi nr. 03/2322). Pastaj, me Vendimin e datës 14.11.2023, nr. 03/2404, është formuar grupi punues më koordinatore menaxheren e personelit.
Ky grup pune përbëhet nga një numër i arsyeshëm anëtarësh, udhëheqësit e zyrave administrative si dhe profesorë nga njësi të ndryshme akademike. Grupi punues shqyrton kornizën ligjore (rregulloret, planet, kontrollin e brendshëm të auditimit, sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, si dhe burime të tjera informacioni për fushat dhe proceset e punës). Grupi punues ka mbajtur trajnimin nga Lëvizja Fol më datë 17/11/2023. Gjithashtu, një pjesëtar i grupit punues ka mbajtur trajnimin në Podgoricë, më datë 19 dhe 20 dhjetor 2023. Grupi punues ka mbajtur edhe takime të veçanta në UKZ në Janar 2024.
- Faza e dytë: Grupi punues ka përpiluar pyetëSORIN gjithëpërfshirës dhe i njëjti i është shpërndarë stafit më datë 19/01/2024. Mbi bazën e rezultatit të pyetëSORIT, janë përcaktuar fushat e rrezikut dhe identifikimi i rreziqeve.
- Faza e tretë: Grupi punues ka përdorur të dhënat e siguruara për t'i përpiluar tabelat e rrezikut dhe adresuar cënueshmërinë e integritetit dhe ka propozuar masat për përmirësim. Në fund, UKZ ka publikuar planin e integritetit tek menaxhmenti dhe ka miratuar masat për përmirësimin e integritetit për periudhën tre (3) vjeçare.

Metoda e vlerësimit të rrezikut

Metoda e Vlerësimit të rreziqeve përcakton probabilitetin e shfaqjes dhe pasojave të cenimit të integritetit dhe formave të tjera të sjelljes së paligjshme ose joetike.

Përmes vlerësimit të rrezikut përcaktohet mundësia e ndodhjes dhe niveli i pasojës, i cili mund të jetë: i ulët/i mesëm/i lartë. Niveli përfundimtar i rrezikut përcaktohet sipas matricës së rrezikut, në formën e një kombinimi mes mundësisë dhe pasojës.

Figura 1 . Matrica e vlerësimit të rrezikut


Pasoja /Ndikimi	Madhor	10																	
		9																	
		8																	
	Mesatar	7																	
		6																	
		5																	
		4																	
	Vogël										4	5	6	7	8	9	10		
											Ulët		Mesatar			Lartë			
											Intenziteti i rrezikut (gjasat X ndikimi)								
				Probabiliteti/Gjasat															

Intenziteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", treguar në figurën si më lartë. Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të cenimit të integritetit, vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 - 16	16 - 48	49 - 100

Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.

Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.

 Rreziku me intensitet të lartë – korrupsioni ose format e tjera të cenimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi nga Zyrtari përgjegjës (sipas Vendimit nr. 03/2322) dhe nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në hartim ashtu edhe në zbatim, dhe se procedurat janë kuptuar, si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu, monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e rrezikut kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioriteteve të rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësimë duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit është bërë në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur. Gjithashtu, pas hartimit të raportit për zbatimin e planit të integritetit nga zyrtari përgjegjës brenda UKZ-së, raporti duhet i dërgohet për vlerësim në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Fushat e rrezikut

Fushat e përgjithshme të rrezikut shembull janë:

- Fusha e menaxhimit të universitetit;
- Fusha e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve;
- Fusha e menaxhimit financiar;
- Komunikimi dhe informimi si dhe zyra e IT-së;
- Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumenteve etj.
- Integriteti akademik i profesorëve

Fushat specifike mund të ndryshojnë varësisht nga specifikat e Institucionit.

Fushat e specifike të rrezikut shembull janë:

- Njësitë tjera të Administratës Qendrore /Fusha e shërbimeve për student;
- Zyra e Cilësisë;
- Projektet ndërkombëtare;
- Menaxhimi i kontratave.

Planit i Integritetit							
Fushat e përgjithshme të rrezikut							
Regjistrimi i rrezikut		Vlerësimi dhe maaja e rrezikut		Veprimi ndaj rrezikut			
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut		
Menaxhimi	Cenimi i integritetit dhe shmangia e konfliktit të interesit	Kodi Etik Këshilli i Etikës Komisioni Disiplinor Raportimet	7		Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
					Masat: Politika të qarta për të adresuar konfliktet e interesit dhe për të promovuar integritetin në të gjitha nivelet e universitetit. Trajnimi i stafit: duhet të bëjë qartë që stafi kupton dhe respekton politikën lidhur me integritetin dhe konfliktet e interesit përmes trajnimeve dhe sensibilizimit.	Menaxhmenti	Janar-Qershor 2024

				<p>Monitorimi dhe raportimi: vendosja e një sistemi për të monitoruar dhe raportuar konfliktet e interesit dhe shkeljet potenciale të integritetit.</p> <p>Pavarësi akademike: sigurimi që proceset vendimmarrëse dhe kërkimi akademik janë të pavarura nga ndikimet e jashtme dhe konfliktet e interesit.</p>		
	<p>Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të auditorit</p>	<p>Raporti i auditorit</p> <p>Përgjigja në rekomandime</p>	<p>8</p>	<p>Masat:</p> <p>Caktimi i një ekipi përgjegjës për ndjekjen dhe implementimin e rekomandimeve</p> <p>Ndjekja e afateve;</p> <p>Raportimi periodik;</p> <p>Rivlerësimi i proceseve;</p>	<p>Menaxhmenti</p>	<p>Sipas afateve</p>
<p>Transparenca</p>	<p>Publikimi i dokumenteve në çebfaqe</p>		<p>7</p>	<p>Masat:</p> <p>Politika të qarta për informacion financiar dhe vendimmarrje e cila do të forcojë bashkëpunimin në universitet,</p>	<p>Menaxhmenti</p>	<p>Janar-Qershor 2024</p>

	Ankimimi	Komisionet e rregullta dhe ad hoc për shqyrtimin e ankesave	8	20	<p>transparencë në publikim të dokumenteve</p> <p>Masat: Për të parandaluar rreziqet që lidhen me ankesat, është e rëndësishme për institucionin të ketë një sistem elektronik efikas për mbledhjen dhe trajtimin e ankesave.</p>	Menaxhmenti	2024
Reputacioni	Plani i integritetit; Interesimi i madh për regjistrim të studimeve Bashkëpunimi me institucione tjera Partneritetet me bizneset Partneritetet ndërkombëtare/Marrëveshjet e bashkëpunimit	4	5	20	<p>Për të parandaluar rreziqet për reputacionin, UKZ duhet të kujdeset për integritetin akademik, komunikimin efikas për menaxhimin e krizave dhe përmirësimin e performancës së përgjithshme për të ruajtur imazhin pozitiv të institucionit.</p> <p>Masat e propozuara: Menaxhimi i krizave (përgatitja për situata të papritura dhe përgjigja efikase ndaj tyre ndihmon në minimizimin e ndikimit negativ në reputacion.</p>	Menaxhmenti	Janar-Qershor 2024

					<p>Komunikimi transparent (informimi i rregullt dhe transparent me publikun lidhur me zhvillimet dhe veprimet në universitet që ndihmojnë në mbajtjen e besimit dhe respektit.</p> <p>Menaxhimi i mediave sociale (përfaqësimi pozitiv dhe përgjigjet e shpejta në media sociale janë të rëndësishme për të parandaluar përhapjen e informacioneve negative.</p> <p>Monitorimi i feedback-ut: përmbajtja e ankesave dhe reagimeve të studentëve dhe stafit duhet të monitorohet dhe trajtohet me seriozitet për të përmirësuar perceptimin në komunitet</p> <p>Forcimi i praktikave etike (zbatimi i standardeve etike dhe akademik të larta ndihmon në ruajtjen e reputacionit të universitetit.</p>		
--	--	--	--	--	---	--	--

	Teknologjia dhe siguria kibernetike	Zbatimi i standardeve aktuale për siguri kibernetike. Sistemet softwerike te sigurisë kibernetike	9	18	Përditësimi i standardeve, sistemeve. Trajnimi i vazhdueshëm i stafit përgjegjës, monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të masave për sigurinë kibernetike	Menaxhmenti/ Zyra e IT	Janar-Qershor 2024
Menaxhimi	Mosfunksionimi i sistemit digjital te protokollit	Protokolli në kopje fizike /manuale	6	24	Zbatimi i sistemit digjital të protokollit	ZKA	2024
	Mosfunksionimi i arkivit digjital	Arkivi në kopje fizike			Zbatimi i sistemit digjital të arkivit		
	Mosfunksionimi i sistemit digjital të bibliotekës	E-biblioteka			Zbatimi i sistemit digjital të bibliotekës		
Burimet Njerëzore, etika profesionale	Rekrutimi i stafit	Ligjet Rregulloret e brendshme Kriteret e konkursit Komisionet	8	16	Masat: Rrije e numrit të stafit në zyrën për burime njerëzore	ZKA/ Menaxheri i BNJ	2024
	Mungesa e një plani vjetor detal të trajnimeve për të gjithë punonjësit Mangësi buxhetore për aktivitetin e trajnimeve	Përgatitja e përcësishme e planit të trajnimeve sipas nevojave reale të UKZ-së Mungesë e kriterëve për vlerësimin e trajnimeve	5	15	Hartimi dhe miratimi i një Plani Vjetor të trajnimeve, bazuar në identifikimin nevojave brenda institucionit Parashikimi në rregulloren e brendshme për vlerësimin e trajnimeve	ZKA/ Menaxheri i BNJ	Janar-Qershor 2024

	Angazhimi nëpunësve në detyra shtesë përshkrim të punës	Vendimet	6	4	24	Parashikimi në Rregulloren e Brendshme të UKZ-së mbi angazhimin e stafit në detyra shtesë të ndërlidhura me detyrat parësore të tyre	ZKA/ Menaxheri i BNJ	Janar-Qershor 2024
	Tejkalimi i kompetencave në detyrën zyrtare	Përshkrimi i detyrave të punës	4	6	24	Masat: Të njihen personalisht me përshkrimin e punës që do të kryejnë sipas pozicionit, duke iu përmbajtur përcaktimeve të tij Zbatim më efikas të kontrollit të brendshëm në Universitet.	ZKA/ Menaxheri i BNJ	Janar-Qershor 2024
	Respektimi i procedurave dhe rregullave të punës nga personeli i UKZ-së në gjatë ushtrimit të detyrave	Kontrolli i vazhdueshëm i punës akademike dhe administrative	4	7	28	Raportimi dhe komunikimi efektiv Trajnim dhe ndërgjegjësim shtesë	Menaxhmenti/ ZKA/ Menaxheri i BNJ	

Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit	Qëndrueshmëria Financiare	Korniza afatmesme e shpenzimeve – KASH;	5	8	40	Pavarësimi financiar;	Këshilli Drejtues	2024-2026
	Përcaktimi i kufijve buxhetor ne nivel qeveritar mund te kufizoj aktivitetin financiar ne te permbushje objektive strategjike.	Plani financiar buxhetor afatmesëm;				Gjetja e burimeve te alternative financuese;	Menaxhmenti/ ZKF	
		Grantit qeveritar;						
	Menaxhimi dhe llogaridhënia	Sistemi i brendshëm i kontrollit siguron cilësi dhe standarde profesionale ne pune;	10	20		Zhvillimi i trajnimeve të profesionale vazhdueshme politike aktuale financiare;	Menaxhmenti/ ZKF IKAP	2024-2026
	Mos-zbatimi i politikave, ligjeve, procedurave dhe rregulloreve qeveritare lidhur me planin dhe shpenzimin e parasë publike.	Auditori i brendshëm, MASHT; Zyra Kombëtare e Auditorit;				Njoftimi në kohë reale me ndryshimet ligjore dhe procedurale;		
	Buxhetimi i aktiviteve	Raportimi dhe mbikëqyrja e rregullt menaxheriale;	4	7	28	Mbikëqyrja dhe rishikimi i vazhdueshëm i planit buxhetor dhe KASH.	Menaxhmenti /ZKA/ZKF	2024-26
	Financimi aktiviteve në jo harmoni me planin strategjik të UKZ	Mbikëqyrja e raporteve financiare nga Këshilli Drejtues;				Inicimi i procedurave të prokurimit nga Njësitë Përgjegjëse; Zbatimi i planit të prokurimit;		

IT dhe Zyra e informimit	Konfidencialiteti	Zbatimi i Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale	6	12	Masat: Mirëmbajtja e vazhdueshme e sistemeve, licencave të sigurisë për të gjitha sistemet të cilat përbëjnë të dhëna apo dokumentacione të ndjeshme në përputje me legjislacionin në fuqi. Përditësimi i sistemeve softërike dhe pajisjeve hardërike.	Menaxhmenti/ IT dhe Zyra për informim	2024
		Përdorimi i sistemeve dhe politikave të sigurisë për mbrojtjen e të dhënave të publikuara				Zyra për Informim/ Zyra e IT-së	Janar-Qershor 2024
		Përditësimi i vazhdueshëm i informatave të publikuara.				Zyra për Informim/ Zyra e IT-së	Janar-Qershor 2024
Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumentacionit	Mirëmbajtja dhe përditësimi i rregullt i informatave në çeb faqen e UKZ	Përditësimi i vazhdueshëm i informatave të publikuara.	7	21	Të respektojnë dispozitat ligjore që rregullojnë konfidencialitetin, informimin publik, konsultimin publik dhe transparencën	Zyra për Informim/ Zyra e IT-së	Janar-Qershor 2024
	Transparenca dokumente	Publikimi i vazhdueshëm i dokumenteve nëpër të gjitha platformat që përdor institucioni	7	21	Zbatimi i vazhdueshëm i rregullave të përcaktuara në bazë të legjislacionit në fuqi	ZKA/Zyra për Informim/ Zyra e IT-së/ UKZ	Janar-Qershor 2024

Integriteti akademik	Plagjiatura	Sistemi anti plagjiat Stafi akademik/Këshilli i Fakultetit Senati Komisioni i Studimeve Komisionet Recensuese	6	18	Masat: Sistem më efikas; Sanksionet konsistente. Përcaktimi dhe zbatimi i sanksioneve për studentët që bëjnë plagjiaturë, duke përfshirë ndëshkime disiplinore dhe humbje të vlerave të notave.	Menaxhmenti	Janar-Qershor 2024
	Shkelja e kodit etik dhe sjellja e paligjshme	Kodi i Etikës Komisioni i Etikës	4	24	Të kryejnë detyrat me profesionalizëm, me kompetencë, duke respektuar një proces të rregullt ligjor, brenda kufijve të kompetencave të tyre; të shmangin çdo veprim që diskrediton profesionin e tyre Masat: Masat e parapara me Kodin e Etikës dhe rregulloret e brendshme	Menaxhmenti i Komisioni i Etikës	Janar-Qershor 2024
	Raportimi i lirshëm i ndonjë rast të korrupsionit, konfliktit të interesit apo ndonjë shkelje tjetër të integritetit	Personi përgjegjës për raportim të konfliktit të interesit Personi përgjegjës për sinjalizim	7	8	16		Menaxhmenti

Prokurimi dhe menaxhimi i kontratave	Staf i pamjaftueshëm dhe certifikimi i stafit rezervë	Operimi i zyrë me vetëm një staf	8	24	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i zyrtarëve të prokurimit Rritja e kapaciteteve në staf	ZKA/ Zyra e prokurimit	Janar-Qershor 2024
	Sigurimi i dosjeve	Ruajtja në zyrën e arkivit të UKZ	5	45	Siguri më e lartë e dosjeve	ZKA/ Zyra e prokurimit/ Zyrtarja e arkivit	2024
Fushat e veçanta të rrezikut							
Regjistrimi i rrezikut							
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Vlerësimi dhe matja e rrezikut		Veprimi ndaj rrezikut		
			Gjasat	Ndikimi	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve		
			Vlerësimi i rrezikut		Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati realizimit	

Zyra e Cilësisë	Përshatshmëria me Standardet Akreditimit	Instrumentet e vlerësimit Rregullorja për Cilësi KMCV	9	27	Mbikëqyrje e vazhdueshme e cilësisë përmes instrumenteve të vlerësimit bazuar në Rregulloren për Sigurim të Cilësisë	Menaxhmenti/ Drejtori	2024
	Mungesa e përgjegjësisë dhe ndërgjegjësisë të stafit ndaj zyrës së cilësisë	Njoftimet e vazhdueshme nga zyra Pyetësorët Instrumentet e vlerësimit	4	32	Ngritje e kapaciteteve për sigurim të cilësisë nëpër Njësi Akadematike	Menaxhmenti/ Drejtori	2024
Zyra Shërbimit të studentëve	Cilësia e shërbimeve për studentë	Kontrolli dhe monitorimi i vazhdueshëm	7	21	Masat: Avancimi në sistemin e shërbimeve elektronike duke avancuar dhe evituar procedurat administrative	ZKA/ Udhëheqësi i Shërbimit të studentëve	Janar/ Qershor 2024
	Vonesat dhe burokracitë	Procedurat administrative	5	20	Evitimi i burokracive duke mënjeluar shërbimet në letra/ Digitalizimi Nënshkrimet elektronike	ZKA/ Udhëheqësi i shërbimit të studentëve/ zyrtarët/ Sekretarët	Janar-Qershor 2024

Projektet ndër-kombëtare	Menaxhim projekteve	Zbatimi konform rregullave të programit dhe vendimeve të brendshme	5	Përshkrim i saktë i detyrave me Vendime të shkruara dhe respektim i plotë i tyre	2024
	Stafi pamjaftueshëm	Stafi aktual nga dy zyrtarë	7	Rekrutim i stafit	
Zyra Ligjore	Aspekti ligjor dhe Rregullativ	Ligjet Statuti Rregulloret Zyra Ligjore	7	Zbatimi i legjislacionit dhe rregulloreve të brendshme. Të njihen me përditësimet ligjore apo administrative të legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil, si dhe Rregulloret e Brendshme të UKZ-së Përmirësimi i proceseve administrative, përshtatja e politikave me standardet aktuale dhe monitorimi i ndryshimeve ligjore janë mënyra më efektive për të përballuar këtë rrezik dhe për të shmangur pasojat negative të mundshme Masat: Rekrutimi i stafit	2024